URDHËR
Nr. 593, datë 5.1.2018

PËR DELEGIM KOMPETENCASH PËR PROCEDURAT E PROKURIMIT PUBLIK

Mbështetur në nenin 102, pika 4, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në ligjin 23/2015 "Për shërbimin e jashtëm të RSH-së", në nenet 22 e vijues të ligjit nr. 44, datë 30.4.2015 "Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", të ndryshuar, dhe vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 914, datë 29/12/2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", të ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Delegimin e kompetencës së titullarit të autoritetit kontraktor, Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme, Sekretarit të Përgjithshëm, z. Gazmend Barbullushi, për nënshkrimin e akteve të procedurave të prokurimit, vlera e të cilave, brenda një viti kalendarik, është më e madhe se 800 000 (tetëqind mijë) lekë.
2. Këto kompetenca do të ushtrohen nga data e daljes së këtij urdhri.
3. Sekretari i Përgjithshëm nuk mund të nëndelegojë këto kompetenca.
4. Delegimi i kompetencave mbaron me revokimin e aktit të delegimit, si dhe pushimin e ekzistencës së organit delegues apo të deleguar.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI PËR EVROPËN
DHE PUNËT E JASHTME
Ditmir Bushati